

VENDIM
Nr.864, datë 5.12.2007

**PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMEVE TË DOKTORATËS NË
INSTITUCIONET TË ARSIMIT TË LARTË DHE PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE,
QË DUHET TË PLOTËSOJË STUDENTI PËR MARRJEN E DIPLOMËS PËR
GRADËN SHKENCORE “DOKTOR”**

*(Ndryshuar me vendimin nr. 877, datë 18.6.2008, nr.103, datë 17.2.2010, nr.593, datë
18.8.2011)*

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 e 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Institucioni i arsimit të lartë, që aplikon për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, duhet të jetë universitet, akademi apo qendër ndëruniversitare dhe shkollë e lartë universitare që paralelisht aplikon për statusin e universitetit.

2. Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat plotësojnë kushtin e përcaktuar në pikën 1, duhet të paraqesin kërkesën pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, e cila shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Dokumentin në të cilin përcaktohen fusha shkencore dhe emërtimi i programit të studimit të doktoratës, i cili duhet t’i referohet një fushë studimi, disipline ose mund të jetë ndërdisiplinore dhe të shoqërohet nga relacioni shpjegues përkatës për interesin që paraqet fusha;

b) programin e studimit, të miratuar nga senati akademik i institucionit, i cili duhet të paraqitet sipas rregullave të parashikuara në statut dhe të përmbajë edhe organizimin, didaktik dhe shkencor, të programit, planin mësimor për fazën e thellimit teorik, si dhe parashikime për periudha të qëndrimit në institucione të huaja kërkimore;

c) afatet kohore të realizimit të programit të studimit;

ç) tarifën e studimit për çdo student, e argumentuar, si dhe burime të tjera financimi, për studimet e doktoratës, nëse ka të tilla;

d) parashikimin për numrin maksimal të studentëve, që mund të regjistrohen çdo vit në programet e doktoratës, jo më i vogël se tre;

dh) personelin akademik, që do të mbulojë realizimin e disiplinave teorike të studimeve të doktoratës, si dhe udhëheqjen e disertantëve, sipas titullit apo gradës shkencore, dhe numrit përkatës të studentëve, për çdo udhëheqës. Nëse në ekipet mësimore mund të përfshihet dhe personel akademik i ftuar, ai duhet të jetë i miratuar nga këshilli i profesorëve të fakultetit;

e) rregulloren për studimet e doktoratës;

ë) të dhënat për strukturën organizative dhe drejtimin e programeve të studimit, nësinë bazë, që drejton administrativisht programin e doktoratës, kur kjo është ndërdisiplinore etj.;

f) dokumentin për përvojat e mëparshme të strukturave në formime pasuniversitare, nëse ka pasur;

g) Marrëveshje të institucionit të arsimit të lartë, së paku me një universitet të një vendi të zhvilluar, që garanton programe të shkëmbimit të personelit akademik dhe të studentëve të doktoratës, si dhe realizim të projekteve kërkimore të përbashkëta. Për shkencat albanologjike bashkëpunimi mund të jetë edhe me një institucion të arsimit të lartë apo qendër kërkimore në

Kosovë dhe në trojet shqiptare;

gj) njësinë apo njësitë bazë propozuese të programit të studimit të doktoratës, që garantojnë ekzistencën e infrastrukturës së nevojshme, ndërtimore e laboratorike, për zhvillimin e programit;

h) modelin e diplomës.

i) Të dhëna për personelin akademik të huaj që do të angazhohet si udhëheqës shkencor ose si bashkëpunëtor shkencor i doktorantëve;

3. Shfuqizuar.

4. Këshilli i profesorëve përzgjedh udhëheqësit shkencorë, të aftë për të drejtuar punën kërkimore të studentëve, mbështetur në vlerësimin e veprimtarive kërkimore botuese të tyre, brenda e jashtë vendit.

Udhëheqësi shkencor i studentit është përgjegjës për drejtimin, këshillimin, vlerësimin e nevojave të studentit, si dhe për zhvillimin e monitorimin e përparimit të punës kërkimore të studentit. Ai ka titullin akademik “Profesor”. “Profesor i Asociuar” ose gradën shkencore “Doktor” (PhD), të fituar në universitetet e vendeve të zhvilluara dhe ka veprimtari të pasur kërkimore dhe botuese në fushën përkatëse shkencore.

Lista e shteteve, doktorata e të cilave konsiderohet për këtë qëllim, miratohet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH) Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë (KVTA) dhe Konferencës së Rectorëve.

Numri i studentëve të udhëhequr njëkohësisht nga një udhëheqës përcaktohet në rregulloret e institucionit, sipas propozimit të këshillave të profesorëve të njëjësive kryesore përkatëse.

5. Gjatë periudhës së studimeve të doktoratës, përpara paraqitjes në provimin e doktoratës, studenti duhet të ketë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Të ketë realizuar, si autor i parë, së paku, tri referime ose paraqitje (poster) shkencore, nga të cilat dy referime ose paraqitje duhet të jenë mbajtur në veprimtari shkencore ndërkombëtare, në një vend të zhvilluar (simpozium, konferencë, kongres), të pranuar në bazë të një vlerësimi paraprak shkencor dhe të botuara në “Proceedings”, të indeksuara me kod ISBN-je. Lista e shteteve, në të cilat veprimtaritë shkencore ndërkombëtare dhe referimet e mbajtura ose paraqitjet (poster) shkencore do të njihen, miratohet me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të Këshillit të Arsimit të Lartë dhe Shkencës (KALSH), Komisionit të Vlerësimit të titujve Akademikë dhe Konferencës së Rectorëve.

b) Të ketë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë në revista shkencore. Së paku dy prej artikujve duhet të jenë botuar ose pranuar për botim në revista shkencore të njohura të vendeve të zhvilluara sipas listës së miratuar me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, me propozim të KALSH-it, KVTA-së dhe Konferencës së Rectorëve;

c) Të ketë përgatitur dhe paraqitur në Këshillin e profesorëve të fakultetit disertacionin, së bashku me një përmbledhje, të miratuara nga udhëheqësi shkencor. Struktura e disertacionit dhe e përmbledhjes së tij përcaktohen në rregulloren e studimeve të doktoratës;

d) Të ketë dhënë provimin e gjuhës angleze, mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare.

5/1. Promovimi i përshpejtuar i shkencëtarëve të rinj të talentuar të bëhet si më poshtë vijon:

a) Kandidatët, që kanë diplomë universitare të nivelit të dytë (DND) ose diplomë universitare të integruar të nivelit të dytë (DIND) dhe kanë botuar, si autor i parë, së paku tre artikuj shkencorë, në revista të huaja, me faktor impakti mbi 1.0, kanë të drejtë t'i paraqesin dekanit të fakultetit dhe, për dijeni, rektorit të institucionit të arsimit të lartë, që ofron studime të doktoratës, një kërkesë për mbrojtjen e doktoratës, mbi bazën e artikujve shkencorë të botuar (disertacion kumulativ). Kërkesa duhet të jetë e shoqëruar nga dy referenca/rekomandime nga profesorë, të vendit ose të huaj, që vlerësojnë se vëllimi dhe cilësia e punimeve shkencore të përfunduara me botimet e sipërpërmendura, plotësojnë kushtet për kërkimin e gradës shkencore “Doktor” dhe i propozojnë këshillit të profesorëve e dekanit ngritjen e jurisë për

provimin e doktoratës.

b) Dekani i fakultetit ia kalon kërkesën menjëherë këshillit të profesorëve, për shqyrtim, i cili shprehet, brenda një muaji nga marrja e kërkesës, për ngritjen e jurisë për provimin e doktoratës. Dekani nxjerr urdhër për ngritjen e saj.

c) Juria, brenda një muaji, vlerëson provimin e doktoratës së kandidatit, sipas vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për hapjen e programeve të studimeve të doktoratës, në institucionet publike të arsimit të lartë, dhe përcaktimin e kushteve, që duhet të plotësojë studenti, për marrjen e diplomës për gradën shkencore “Doktor”, të ndryshuar.

ç) Kandidatët, që nuk janë në marrëdhënie pune në një institucion të arsimit të lartë, i dërgojnë kërkesë dekanit të fakultetit të institucionit të arsimit të lartë, që zhvillon studime të doktoratës në fushën ku është kryer kërkimi shkencor dhe është përgatitur teza e disertacionit në formë kumulative.

d) Në rastet kur dekani dhe këshilli i profesorëve, të fakultetit, shprehen negativisht për kërkesën e kandidatit/es, ai/ajo ka të drejtë të ankohet te rektori i institucionit të arsimit të lartë dhe te Ministri i Arsimit dhe Shkencës, si dhe të kërkojë një rivlerësim të kërkesës.

5/2. Juria përbëhet nga 5 (pesë) veta, ku të paktën tre prej të cilëve duhet të kenë titullin “Profesor”. Në rastet kur nuk mund të gjenden dy anëtarët e tjerë me këtë titull, pranohen anëtarë me titullin “Profesor i asociuar” dhe kanë përvojë të mjaftueshme akademike e shkencore brenda dhe jashtë vendit. Përbërja e jurisë i propozohet Këshillit të Profesorëve nga koordinatori i programit të doktoratës/përgjegjësi i departamentit. KP-ja shqyrton propozimin dhe miraton jurinë për zhvillimin e provimit të doktoratës. KP-ja përcakton dy ose tre oponentë, një prej të cilëve duhet të jetë nga jashtë institucionit. Oponentët janë edhe anëtarë të jurisë për vlerësimin e disertacionit. Ata duhet të kenë titujt akademikë të kërkuar dhe veprimtari kërkimorë e botuese të pasur, brenda e jashtë vendit, në fushën përkatëse të studimeve, në të cilën ofrohet edhe programi i studimeve të doktoratës.

Një anëtar i jurisë së provimit të doktoratës mund të jetë nga universitete të njohura në botë, për cilësi dhe veprimtari të pasur kërkimorë dhe botuese në fushën përkatëse, i cili ka, së paku, gradën shkencore “doktor”, të fituar në fushën shkencore në të cilën vazhdon studimet doktoranti, dhe mbi 5 (pesë) vjet përvojë akademike e kërkimorë. Ky kriter mund edhe të mos zbatohet për shkencat albanologjike.

Vlerësimi i doktorantit në provim bëhet i hapur.

5/3. Grada shkencore “Doktor” është e revokueshme në çdo kohë dhe për çdo rast, që konstatohet plagjiaturë ose manipulim të dhënash në punimet e kandidatit. Në këtë rast, dekani i kërkon Këshillit të Profesorëve të mblidhet menjëherë dhe ta shqyrtojë rastin e konstatuar. Vendimi i Këshillit të Profesorëve shqyrtohet nga Këshilli i Etikës së Institucionit të Arsimit të Lartë, i cili i propozon rektorit të këtij institucioni revokimin e gradës shkencore “Doktor”, të fituar nga kandidati. Rektori, pasi e shqyrton, merr vendim, të cilin ia dërgon kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Titujve Akademikë për të bërë çregjistrimin nga regjistri përkatës i këtij Komisioni. Të drejtën e revokimit të gradës shkencore “Doktor” e ka edhe rektori i institucionit përkatës të arsimit të lartë, edhe Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademikë, kur ka informacione të besueshme në lidhje me këtë çështje. Të drejtën e revokimit të gradës shkencore “Doktor” e ka institucioni, që e ka lëshuar diplomën për marrjen e kësaj grade, edhe në rastet kur konstatohet plagjiaturë apo manipulim të dhënash në studime/punime kërkimorë të kryera pas promovimit për marrjen e saj.

6. Institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programet e studimet të doktoratës, i organizojnë ato brenda standardeve të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe sipas rregullores së institucionit përkatës.

7. Studentët, që janë regjistruar në studimet e doktoratës:

a) përpara datës 31 dhjetor 2005, kanë plotësuar kërkesat e vendimit nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor, pasuniversitar dhe për

klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar, dhe dorëzojnë në dekanat dosjen e plotë, me disertacionin e përfunduar, deri më 31 dhjetor 2008, kryejnë mbrojtjen e doktoratës, sipas procedurave të parashikuara në shkronjën “c” të pikës 5 të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave.

b) nga data 1 janar 2006 deri më 31 dhjetor 2007 dhe studentët e përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 7, por që nuk arrijnë të dorëzojnë dosjen brenda afatit të përcaktuar më sipër, do t’i vazhdojnë studimet në ciklin e rregullt, sipas vendimit nr.786, datë 17.12.1998 të Këshillit të Ministrave “Për kualifikimin shkencor pasuniversitar dhe për klasifikimin e punonjësve, pedagogjikë e kërkimorë”, të ndryshuar, por do të plotësojnë kriteret e pikës 5 të vendimit nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave, për mbrojtjen e doktoratës.

c) pas datës 1 janar 2008 e në vazhdim, i përfundojnë ato në përputhje me ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe me vendimin nr.864, datë 5.12.2007 të Këshillit të Ministrave.

8. Të gjitha institucionet publike të arsimit të lartë, që ofrojnë programe të studimeve të doktoratës, sipas ligjit nr.8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, duhet të riorganizojnë strukturimin e këtyre programeve, sipas kërkesave dhe standardeve të parashikuara në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në këtë vendim, dhe duhet të paraqesin, për rivlerësim dhe miratim, sipas këtij vendimi, këto programe studimesh, e nëse nuk arrijnë miratimin ato nuk do të marrin kuota të reja studimi.

Institucionet publike të arsimit të lartë, sipas përcaktimeve në pikën 9 të këtij vendimi nuk mund të pranojnë studentë të rinj në studimet e doktoratës, deri në miratimin e tyre, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në këtë vendim dhe në ligjin nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

9. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe institucionet publike të arsimit të lartë, të cilat ofrojnë programe të studimeve të doktoratës, si dhe ato institucione, të cilat do të ofrojnë programe të studimeve të doktoratës për zbatimin e këtij vendimi. Institucionet publike të arsimit të lartë duhet të parashikojnë në statutet e tyre organizimin e studimeve të doktoratës, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

10. Të gjitha aktet nënligjore të mëparshme, të cilat bien ndesh me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha